

<b>RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	
<b>EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS</b>	Projektligj “Për Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Largimin, Grumbullimin e Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane”
<b>MINISTRIA UDHËHEQËSE</b>	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)
<b>FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	Faza finale – projektligji i përgatitur
<b>BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS</b>	I brendshëm
<b>DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së</b>	Jo e zbatueshme
<b>PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA</b>	Strategjia Kombëtare Sektoriale e Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017; Draft Strategjia Kombëtare Sektoriale e Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2019 – 2030.
<b>DATA E KONSULTIMIT PUBLIK</b>	15 – 16 Tetor 2019
<b>DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	
<b>A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT</b>	
<b>NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	2019 – MFE- 11
<b>TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)</b>	Enea Karakaçi, Drejtor i Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator enea.karakaci@infrastruktura.gov.al
<b>PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)</b>	
<b>PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT</b>	
<i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?</i>	
<p>Sektori i furnizimit me ujë në Shqipëri përballlet me sfida të rëndësishme të cilat kanë vënë në pikëpyetje arritjet dhe punën e mirë që është bërë ndër vite në drejtim të përmirësimit të zhvillimit të këtij sektori i cili është objektiv strategjik për Qeverinë Shqiptare. Kjo e fundit është bashkësponsorizuese e Rezolutës së Kombeve të Bashkuara për ta bërë “Aksesin në Ujë të Pijshëm të sigurtë dhe Kanalizime, të drejtë të njeriut”. Gjithashtu, Qeveria Shqiptare është e angazhuar të garantojë cilësinë për të gjithë qytetarët, për sa i përket të drejtave të njeriut për ujin e pijshëm dhe kanalizimet.</p> <p>Pavarësisht zhvillimeve dhe ndërhyrjeve legjislative që ka pësuar ky sektor ndër vite, ku vlen të përmendim këtu decentralizimet e shërbimit të ujësjellësve, investimet e rëndësishme në infrastrukturën e sektorit nga Qeveria Shqiptare apo edhe nga donatorë të ndryshëm, konstatohet se shumica e ujësjellësve nuk arrijnë të furnizojnë me ujë konsumatorët në mënyrë të vazhdueshme për 24 orë, nuk mbulohet me shërbim e gjithë popullata, në disa raste cilësia e ujit nuk është në parametrat teknikë të kërkuar, apo ka probleme të theksuara</p>	

në drejtim të humbjeve në rrjet për shkak të amortizimit të tij dhe mos faturimit të shërbimit apo faturimit të tij aforfe. Performanca financiare aktuale e shoqërive të ujësjellës kanalizime (UK) rezulton e vështirë dhe në shumë raste kërkon mbështetjen financiare nga qeveria. Gjithashtu edhe kuadri rregullator aktual konsiderohet i pa plotë, me ligjin sektorial të aprovuar 23 vite më parë, i cili nuk reflekton zhvillimet e sektorit por krijon mbivendosje kompetencash ndërmjet institucioneve të përfshira.

Për të gjitha këto arsye, ndërhyrja me krijimin e një kuadri rregullator të plotë është e nevojshme me qëllim zhvillimin dhe rregullimin e sektorit të ujit nëpërmjet draftimit të një ligji të ri, i cili u gjykua si opsioni më i përshtatshëm për të rregulluar dhe adresuar të gjitha problematikat e konstatuar ndër vite.

#### **OBJEKTIVAT**

*Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?*

Projektligji ka si qëllim krijimin e një kuadri të plotë ligjor që siguron zbatimin e planeve konkrete dhe kushtet optimale për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, të grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në të gjithë vendin.

Objektivat kryesore të Projektligjit janë rritja e tregueseve të performancës së shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, rritja e investimeve të nevojshme në rrjetet përkatëse të furnizimit me ujë të pijshëm, të grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të këtyre shërbimeve të rëndësishme për jetën e qytetarëve shqiptarë me ndikim minimal në mjedis dhe me kosto të përballueshme për të gjithë konsumatorët.

#### **OPSIONET E POLITIKAVE**

*Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/ëve të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.*

Për arritjen e objektivave të politikave janë shqyrtuar disa opsione të cilat analizohen dhe shtjellohen në pjesën e dytë të këtij dokumenti në seksionin “Përshkrimi i Opsioneve të Shqyrtuara”. Opsioni i preferuar në rastin konkret rezultoi Opsioni 1 – Hartimi i një ligji të ri sektorial për furnizimin me ujë dhe largimin, grumbullimin e trajtimin e ujërave të ndotura urbane.

Sikundër analizohet gjerësisht edhe në këtë dokument, gjendja aktuale e këtij sektori kërkon ndërhyrje dhe ndërmarrje të reformave tërësore duke filluar nga kuadri legjislativ e cila të rregullojë dhe përcaktojë detyra të qarta për secilin nga faktorët e përfshirë në sektor me qëllim zbatimin e detyrimeve dhe objektivave cilësore dhe sasiorë për përmirësimin e performancës së shoqërive ujësjellës kanalizime duke dhënë zgjidhje përfundimtare problematikës shumëvjeçare të sektorit.

#### **ANALIZA E NDIKIMEVE**

*Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.*

Ndikimet ekonomike të opsionit të preferuar kanë impakt të drejtpërdrejtë në financat shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve dhe mund të kenë si pasojë reflektimin e tyre te konsumatori fundor në kushtet e zbatimit të parimit të rikuperimit të plotë koston me qëllim rritjen e performancës financiare të këtyre shoqërive. Projektligji adreson specifikisht këtë çështje duke përcaktuar se këto shoqëri duhet të ushtrojnë aktivitetin e tyre mbi bazën e parimit të rikuperimit të plotë të koston. Megjithatë, kjo mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë te konsumatori fundor duke detyruar shoqëritë UK të kërkojnë rritjen e çmimit të shërbimit. Në

projektiligj përcaktohen modalitet e rritjes së çmimit duke kaluar vendimmarrjen nëpërmjet ERRU-së e cila kryen një analizë të plotë të kërkesës për rritjen e çmimit dhe më pas ka tagrin ligjor të veprave rast pas rasti. Me qëllim shmangien e efekteve negative mbi kategori të caktuara, në projektiligj përcaktohet se duhen identifikuar shtresat në nevojë të cilat duhet të subvencionohen përsa i përket sasisë minimale të furnizimit me ujë, si dhe vendosjes së ujëmatësit dhe kostos administrative për lidhjen e kontratës së furnizimit me ujë.

Gjithashtu, në ligj rregullohet mundësia e përfshirjes së një Operatorit të Alternativës së Fundit (OAF) në rastet kur shoqëritë respektive mund të falimentojnë apo nuk kanë burimet financiare për të vazhduar aktivitetin normalisht. Këto raste duhen monitoruar me kujdes duke u ruajtur balanca e interesit të konsumatorit për të marrë shërbimin në raport me dëshirën e OAF-së për të nxjerrë nga situata e vështirë financiare shoqërinë respektive, me qëllim që masat dhe reformat që do të ndërmerren të mos jenë proporcionalisht më të larta duke u reflektuar më pas në çmimin e konsumatorit fundor. Po kështu, projektiligji lejon mundësinë e përdorimit të OAF-së vetëm përkohësisht dhe në këtë mënyrë kjo përbën një shmangie nga funksioni që ka Bashkia në territorin e të cilit mundësia e një ndikimi që mund të kishte potencialisht në raport me Ligjin 139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore i cili këtë tagër ja njeh Bashkive.

Detyrimi për të shtuar investimet në drejtim të mirëmbajtjes dhe ndërtimit të linjave të reja apo infrastrukturës së nevojshme për përmirësimin e cilësisë së shërbimit. Ndërtimin dhe operimin të impianteve të përpunimit të ujërave të ndotura në zbatim të parimit të shmangies së ndotjes mjedisore mund të ketë kosto të shtuar për shkak të investimit fillestar në ndërtimin e impianteve dhe kostove për mirëmbajtjen e tyre. Qeveria Shqiptare nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë asiston shoqëritë e ujësjellës kanalizimeve me qëllim gjetjen e financimeve të përshtatshme për realizimin e këtyre objektivave të përmirësimit të infrastrukturës. Të gjitha këto investime, në plan afatmesëm dhe afatgjatë duhet të amortizohen me qëllim rikuperimin e plotë të kostove dhe rrjedhimisht ekziston mundësia e shtuar që të ndikojnë drejtpërdrejtë në rritjen e çmimit të shërbimit ndaj qytetarëve. Kjo mund të realizohet duke orientuar investimet drejtë përmirësimit të infrastrukturës me qëllim minimizimin e humbjeve në rrjet, lidhjen e kontratave me të gjithë konsumatorët dhe pajisjen e tyre me matësa, marrjen e masave proaktive për eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjet.

Përfshirja në projektiligj dhe zbatimi i parimit ndotësi paguan, konsiderohet si një përjasje e mirë për adresimin e problemit të mbrojtjes së mjedisit por nga ana tjetër duhen përcaktuar me kujdes mekanizmat e aplikimit të këtij parimi me qëllim që mungesa e efektivitet dhe performancës në punë të shoqërive të ujësjellës kanalizimeve të mos reflektohet në kosto shtesë për shoqëritë UK dhe rrjedhimisht të transferohet te konsumatori fundor në formën e rritjes së çmimit. Sikundër shpjegohet më sipër, kjo çështje adresohet në projektiligj nëpërmjet ERRU-së, i cili është autoriteti që ka tagrin ligjor për të marrë një vendim përfundimtar lidhur me çmimin.

Në ligjin e ri parashikohet shprehimisht mundësia e dhënies me konçesion apo partneritet publik-privat të shërbimeve në fushën e sektorit të ujit duke kryer një studim fizibiliteti të plotë i cili të justifikojë dhënien e këtyre aseteve nëpërmjet formave të bashkëpunimit me privatën por duke mbajtur parasysh gjithmonë karakterin monopol të këtij shërbimi ku duhet të justifikohet dhe monitorohet me kujdes rritjet e çmimit të shërbimeve, detyrë kjo që ligjërisht i përket ERRU-së. Kjo praktikë ka rezultuar e sukseshme në shumë vende

të botës dhe duke qënë se po bëhej një ndërhyrje e tillë legislative, u pa e nevojshme parashikimi i përdorimit të kësaj mundësie nga shoqëritë. Këtu vlen të theksohet se ky koncept është përdorur edhe në të shkuarën në Shqipëri nëpërmjet konçesionit apo kontratës së bashkëpunimit duke u aplikuar në të shkuarën në Elbasan apo në 4 bashki të tjera.

#### **ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR**

*Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.*

Opsioni i preferuar është Opsioni 1, pasi në kushtet aktuale të sektorit të ujit rezulton e domosdoshme për të ndërhyrë me nisma legislative sektoriale me qëllim realizimin e reformave të rëndësishme duke përcaktuar objektiva strategjike ligjore, ndarjen dhe përcaktimin e qartë të kompetencave të secilit institucion të përfshirë në këtë sektor, përcaktimin e detyrimeve ligjore të aktorëve pjesëmarrës në zbatimin e projektligjit, por edhe mekanizmat ligjorë që lejojnë në ndërhyrjen e menjëhershme në rast revokimi liçense apo falimentimi të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve.

Vlera financiare e kostove dhe impaktit që shkakton ky opsion nuk është e mundur të përcaktohet për shkak të kompleksitetit të sektorit të ujit dhe aktorëve të shumtë të përfshirë, procesi nuk ka rezultuar me të dhëna që mund të përdoren për të kryer një analizë të besueshme të kostove pasi kërkohen investime të qënësishme në të paktën disa drejtime sikundër janë, kryerja e investimeve për përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese, ndërtimi i impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura, por edhe investime të tjera që kërkojnë përmirësimin e parametrave të cilësisë së shërbimit.

**Kostoja e përlloritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):**

Viti 1	Viti 2	Viti 3
Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet

#### **KONSULTIMI**

*Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?).*

MIE ka përmbushur detyrimin ligjor për ta konsultuar këtë projektligj nëpërmjet konsultimeve të hapura në mjediset e Ministrisë por edhe duke publikuar projektligjin në faqen zyrtare të saj. Projektligji është konsultuar me ERRU-në, AKUM, shoqëritë UK, Shoqata e Bashkive, Instituti i Shëndetit Publik, Zyrën e Kryeministrit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Gjithashtu, projektligji është realizuar me mbështetjen financiare dhe konsulencën e GIZ, e cila nga ana e saj ka kontraktuar ekspertët më të mirë teknikë dhe ligjorë të fushës.

Për shkak të kompleksitetit të sektorit dhe aktorëve të shumtë të përfshirë, procesi nuk ka rezultuar me të dhëna që mund të përdoren për të kryer një analizë të besueshme të kostove. Megjithatë, pikëpamje dhe sugjerime të aktorëve të përfshirë janë reflektuar gjerësisht në projektligj duke bërë të mundur që të

vlerësojmë kostot në aspektin cilësor sikundër janë përfshirë në këtë Vlerësim Ndikimi.

## **ZBATIMI DHE MONITORIMI**

*Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?*

Në projektligj parashikohet aprovimi i një sërë akte nënligjore me qëllim zbatimin e tij, të cilat kryesisht duhet të hartohen dhe aprovohen nga Këshilli i Ministrave. Këtu vlen që të përmendët aprovimi i VKM-së për subvencionimin e shtresave në nevojë, VKM-së për aprovimin e Operatorit të Alternativës së Fundit me kapital shtetëror, VKM-së për kërkesat e cilësisë për ujin e pijshëm, VKM-së për ndërtimin e sistemeve grumbulluese/kolektorë, impiante të ujërave të ndotura. Gjithashtu, në projektligj parashikohen një sërë mekanizma ligjorë për monitorimin e zbatimit të ligjit sikundër është përfshirja e kontratës së performancës e cila lidhet ndërmjet AKUM dhe shoqërive UK në të cilën përcaktohen objektiva lidhur me performancën e shoqërive. Gjithashtu, edhe ERRU ka prerogativa ligjorë për monitorimin e mbarëvajtjes së punës së shoqërive, në momentin e liçencimit apo rinovimit të liçencave por edhe në shqyrtimin e kërkesave për rritjen e çmimit të shërbimit, kërkesa që duhet të jenë të mirë argumentuara dhe bazuar në plan biznesi, që përmbajnë analizë të kostos apo të dhënat e performancës të shoqërisë respektive.

## **PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE**

### **Historik**

- *Jepni kontekstin e politikës*

Ky projektligj është hartuar në kushtet kur ndërhyrja nëpërmjet një ligji të ri sektorial konsiderohet e domosdoshme, për shkak se reformat pjesore të ndërmarra dhe nismat e Qeverisë Shqiptare ndër vite nuk kanë arritur rezultatin e pritshëm dhe pjesa më e madhe e shoqërive UK kanë probleme të theksuara të performancës financiare dhe shërbimi nuk është në parametrat teknikë sipas objektivave të vendosura nga Qeveria e Shqipërisë në Strategjinë Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve. Në këto kushte, është e domosdoshme që të kryhen reforma tërësore sektoriale duke filluar me aprovimin e një projektligji sektorial të ri i cili ka si qëllim reformimin strukturor të sektorit dhe përcaktimin e objektivave dhe detyrimeve të qarta ligjore që duhet të ndërmerren nga secili prej aktorëve të përfshirë në këtë sektor.

Projektligji në fjalë nuk synon traspozimin në mënyrë të plotë apo të pjesshme të ndonjë direktive të Komunitetit Europian. Ky funksion, për arsye të kompleksitetit teknik që bart, i është deleguar nga projektligji ndërhyrjeve me anë të vendimeve të Këshillit të Ministrave, veçanërisht në lidhje me traspozimin e parametrave të përcaktuara nga Direktiva 91/271/EEC, të 21 majit 1991, për trajtimin e ujërave të ndotura urbane.

### **Problemi në shqyrtim**

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*

- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Problematika e sektorit është komplekse dhe kërkon investime të rëndësishme dhe rezulton se një nga problemet kyçe në këtë sektor mbetet performanca e dobët teknike dhe financiare e shoqërive UK e kombinuar kjo me cilësi të dobët në furnizim me ujë por edhe shtrirje jo të mjaftueshme me qëllim mbulimin e plotë të territorit me shërbim. Referuar statistikave të cilat disponojmë, konstatohet se nga 3 litra ujë e cila prodhohet dhe hidhet ne rrjet, vetëm 1 litër faturohet. Ndërkohë që vlerësohet se rreth 1,200,000 konsumatorë janë të lidhur me rrjetin publik, vetëm 830,000 prej tyre kanë një kontratë furnizimi të lidhur me shoqëritë UK. Ndërsa 190,000 konsumatorë nuk kanë asnjë kontratë të lidhur për këto shërbime. Nga ana tjetër, nga të gjithë konsumatorët të cilët kanë një kontratë furnizimi (830,000 konsumatorë), vetëm 560,000 konsumatorë kanë të lidhur matësa uji ndërsa 270,000 të tjerë nuk kanë matësa fare.

Në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve në vendin tonë operojnë 58 shoqëri publike nga të cilat 42 prej tyre operojnë në kushte të cilat nuk mbulojnë 100% kostot direkte dhe subvencionohen nga Qeveria Shqiptare për një total prej rreth 13 milionë euro në vit. Vlen të theksohet se në Shqipëri, vetëm 7 shoqëri UK mund të ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë më shumë se 20 orë/ditë gjatë gjithë vitit dhe me presionin e duhur, por ky shërbim nuk ofrohet në të tilla parametra në të gjithë territorin administrativ të këtyre bashkive.

Që nga viti 2007, mbulimi i përgjithshëm i furnizimit me ujë ka mbetur i njëjtë, në nivelin 78.3% deri në vitin 2017. Por ky rezultat nuk thekson edhe dallimin e madh midis zonave urbane dhe rurale. Bazuar në të dhënat e 2017, mbulimi me furnizimin me ujë arrin 91.8% në zonat urbane ndërsa mbulimi në zonat rurale arrin në 58.7%.

Kjo situatë problematike në drejtim të menaxhimit të resurseve ujore ka bërë që shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve të prodhojnë rreth 20% më shumë ujë se sa ka realisht nevojë dhe kjo në kushtet kur shërbimi do të ofrohej 24 orë në ditë. Të gjitha këto të dhëna dëshmojnë për probleme të theksuara të sektorit duke bërë që çmimi i shërbimit të rritet artificialisht për konsumatorët të cilat paguajnë rregullisht.

Gjithashtu, shoqëritë UK përballen me nivele të larta të humbjeve të ujit, pasi mirëmbajtja e sistemeve të furnizimit me ujë është e pamjaftueshme. Në vitin 2017, niveli mesatar i ujit pa të ardhura për të gjithë sektorin mbetet i lartë rreth 65%, duke u krahasuar me vitin 2016 ky tregues ka pësuar një rënie prej 2%. Megjithatë, që nga viti 2007, niveli i ujit pa të ardhura nuk ka patur asnjë përmirësim të vërtetë. Për më tepër, niveli i ujit pa të ardhura varion dukshëm midis shoqërive UK, duke filluar nga 12% deri në 84%.

Situata paraqitet problematike edhe në shërbimet me kanalizime dhe trajtimin e ujerave të ndotura. Që nga viti 2007, mbulimi i përgjithshëm me kanalizime është rritur vetëm me 5%. Ky përmirësim ka ardhur për shkak të rritjes së mbulimit të kanalizimeve në zonat urbane, ndërkohë që mbulimi me kanalizime në zonat rurale nuk ka pasur përmirësime. Bazuar në të dhënat e vitit 2017, mbulimi me kanalizime arrin 50.2% në nivel kombëtar nga ku 75.6% në zonat urbane dhe 12.8% në zonat rurale. Nga ana tjetër, rezulton se vetëm 10.45% e popullsisë urbane është e lidhur me impiant trajtimi të ujerave të ndotura, shifër e cila mbetet shumë e ulët ndërkohë në zonat rurale nuk ka mbulim me impiant të trajtimit të ujerave të ndotura. Këto nivele të mbulimit janë shumë

mbrapa objektivitet të përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të furnizimit me ujë dhe kanalizime 2011-2017, i cili synon të arrijë në 40% mbulimin e trajtimit të ujërave të ndotura deri në fund të vitit 2017.

Jo e kënaqshme është gjithashtu edhe efikasiteti dhe efikasiteti i arkëtimit. Niveli mesatar i arkëtimit për sektorin UK në vitin 2017 ishte rreth 86% dhe ka pësuar përmirësime gjatë dekadës së kaluar pavarësisht luhatjeve vjetore të lidhura me zgjedhjet qendrore dhe vendore. Megjithatë, Shqipëria ende mbetet larg krahasuar me praktikën më të mirë ndërkombëtare, të cilat konsiderojnë një minimum prej 95% si nivel të mirë arkëtimit. Midis 54 shoqërive UK që kanë raportuar të dhënat në vitin 2017, vetëm 6 shoqëri UK kanë arritur nivelin e praktikave më të mira ndërkombëtare në lidhje me nivelin e arkëtimit.

Keqmenaxhimi dhe mungesa e një sistemi rregullator të përshtatshëm është shkaku kryesor i situatës së vështirë financiare të shoqërive ujësjellës-kanalizime, duke penguar në këtë mënyrë investimet e nevojshme në sektor të cilët kanë përkeqësuar më tej shërbimin ndaj konsumatorëve.

Grupet e prekura nga problematika e sektorit të ujit janë të gjithë konsumatorët e këtij shërbimi qofshin këta familjarë apo biznese, duke u shtrirë ndikimi negativ i kësaj problematike në të gjithë shoqërinë shqiptare. Prandaj, është i nevojshëm ndryshimi i politikave aktuale të cilat kanë rezultuar jo efektive në drejtim të zgjidhjes së problematikës së mbartur të sektorit.

### **Arsyeja e ndërhyrjes**

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivitetin e nivelin të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Qeveria e Shqipërisë në cilësinë e anëtares së Kombeve të Bashkuara ka miratuar rezolutën e Këshillit të Drejtave të Njeriut duke e njohur të drejtën për ujë të pijshëm të sigurtë dhe kanalizime si e drejtë thelbësore e njeriut. Gjithashtu, në kuadrin e Objektivave Socialë të parashikuara nga Neni 59 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Shteti synon ndër të tjera edhe shfrytëzimin racional të ujërave dhe burimeve natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm. Referuar këtyre objektivave kuadër dhe me qëllim ofrimin e një shërbimi optimal për qytetarët e Republikës së Shqipërisë, në kushtet kur situata e sektorit nuk paraqitet në parametrat normalë të shërbimit dhe performanca e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve paraqitet e dobët, pavarësisht reformave dhe investimeve të kryera nga Qeveria Shqiptare ndër vite, u pa me vend që të ndërmerrej një reformë ligjore sektoriale. Kjo reformë synon të adresojë gjithë problematikën dhe të garantojë mbarëvajtjen e sektorit duke siguruar përmirësim të shërbimit dhe pavarësi financiare të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve. Sikundër shpjegohet në këtë dokument ndërhyrja e Qeverisë është kapilare duke aprovuar një ligj tërësisht të ri dhe përcakton qartë kompetencat e të gjithë aktorëve të përfshirë në sektor duke siguruar mirëfunksionimin e këtij sektori mbi bazën e parimit të rikuperimit të plotë të kosto por nga ana tjetër duke shmangur të gjitha ndikimet negative që mund të prodhojë ndërmarrja e një reforme të tillë sikundër është ndikimi negativ mbi shtresat në nevojë.

Sektori i ujit pavarësisht se ka pasur një kuadër ligjor të posaçëm i cili ka funksionuar kryesisht mbi bazën e Ligjit Nr.8102 datë 28.03.1996 por edhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, konstatohet se janë krijuar shpeshherë mbivendosje të kompetencave ndërmjet institucioneve zbatuese dhe kjo është një prej arsyeve të cilat e bëjnë të nevojshëm ndërhyrjen e Qeverisë me një Ligj tërësisht të ri.

### **Objektivi i politikës**

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivi i politikës lidhet me krijimin e mekanizmave ligjorë që sigurojnë kushtet optimale dhe zhvillim të qëndrueshëm për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, të grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane duke ruajtur mjedisin dhe burimet ujore nga njëra anë por edhe duke mbrojtur konsumatorin nga ana tjetër. Gjithashtu, projektligji përcakton kuadrin institucional qëndror dhe lokal në të cilin parashikohen te drejtat dhe detyrimet e aktorëve të përfshirë në këtë sektor të cilët kanë kompetenca rregullatore, politikëbërëse, operacionale dhe menaxhuese.

Një tjetër objektivi i këtij projektligji është përcaktimi i rregullave dhe normave për zbatimin e planeve konkrete me qëllim sigurimin e ofrimit të kushteve optimale të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, trajtimit dhe largimit të ujërave të ndotura. Po kështu, në projektligj përcaktohen rregulla dhe norma për zbatimin e metodave dhe kushteve për krijimin e shoqërive të qëndrueshme, si dhe ushtrimin e funksioneve të tyre në mënyrën që sigurojnë ofrimin e një shërbimi optimal.

Në projektligj, gjithashtu parashikohen dhe sanksionohen parime të posaçme për zhvillimin e sektorit të cilat përbëjnë orientimin dhe gurin e themelit në drejtim të zhvillimi të sektorit.

### **Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara**

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

**Opsioni 0 (status quo):** të vijohet me kuadrin ekzistues ligjor.

Kuadri ligjor sektorial ekzistues përbëhet nga Ligji Nr. 112/2012 datë 15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, Ligji Nr.8102 datë 28.03.1996 “Për Kuadrin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura”; Ligji Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligji Nr. 7643 date 02.12.1992 “Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror” dhe akte të tjera nënligjore të dala në zbatim të këtyre ligjeve. Ky opsion nuk është i preferuar për shkak se kuadri rregullator aktual rezulton të jetë shumë kompleks me ligje dhe akte nënligjore të ndryshme të cilat në jo pak raste krijojnë konfuzion në zbatim por edhe mbivendosje kompetenca ndërmjet institucioneve të përfshira në këtë sektor. Gjithashtu, konstatohet se kuadri ekzistues ligjor është një nga shkaktoret e problemeve të këtij sektori duke bërë imediate ndërhyrjen me një ligj të ri për ndërmarrjen e reformave legjislative në këtë sektor.

**Opsioni 1 (i preferuar):** Hartimi i një ligji të ri sektorial për furnizimin me ujë dhe largimin, grumbullimin e trajtimin e ujërave të ndotura urbane.

Hartimi i një ligji të ri është analizuar si një mundësi e përshtatshme dhe një mjet efektiv për të adresuar mekanizmat ligjore dhe institucionalë me qëllim përmirësimin e treguesve financiarë të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, decentralizimin e mëtejshëm të këtyre shoqërive në kushtet kur një pjesë e tyre marrin ende subvencione nga Qeveria, duke përmirësuar drejtpërdrejtë shërbimin ndaj konsumatorëve dhe duke rritur orarin e furnizimi me ujë. Gjithashtu, ky opsion përcakton qartësisht kompetencat e institucioneve të përfshira në këtë sektor, qoftë në nivel politikëbërje apo edhe në nivel zbatimi, duke shmangur konfuzionin dhe paqartësitë e krijuara në të shkuarën lidhur me mbivendosjen e kompetencave të organeve shtetërore.

#### **Opsioni 2: Ndërhyrja me akte nënligjore.**

Ky opsion nuk konsiderohet i preferuar përsa kohë kuadri ligjor sektorial aktual ka probleme të theksuara të tij të cilat nëse do të ndërhyhej vetëm me akte nënligjore nuk do të kishin si rezultat përmirësimin e duhur të parametrave të sektorit të ujit por do të rrezikohej të shkaktohej konfuzion i mëtejshëm dhe për rrjedhojë këto masa nuk do të rezultojnë efektive. Prandaj, u konsiderua e përshtatshme që të kishim një kuadër ligjor tërësisht të ndryshuar i cili të adresonte në themel problematikën e konstatuar. Eksperienca ndër vite ka treguar se ndryshimet legjislative janë më efektive në drejtim të zbatimit të tyre, në raport me aktet nënligjore. Gjithashtu, hartimi i një ligji të ri lejon ndërhyrjen kapilare në sektor duke sjellë risi, lejuar parime thelbësore apo duke krijuar mekanizmat ligjorë të nevojshëm për implementimin dhe monitorimin e zbatimit të ligjit, ndërkohë aktet nënligjore nuk lejojnë ndërhyrje të nivelit të tillë.

#### **Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve**

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
  - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
  - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
  - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
  - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
  - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
  - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
  - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
  - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
  - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë ët ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
  - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
  - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*

- *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuara për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Në kuadër të këtij Vlerësimi të Ndikimit, vlerësojmë se, në planin afatmesëm, impakti i përgjithshëm i implementimit të opsionit të preferuar do të jetë pozitiv, duke mundësuar realizimin e objektivave lidhur me sigurimin e qëndrueshëm të ofrimit në kushte optimale dhe me cilësi të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, të grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane, nëpërmjet garantimit të mbulimit të kostove operacionale të shoqërive UK, uljes së nivelit mesatar të ujit pa të ardhura dhe investimet e nevojshme në infrastrukturën tashmë të amortizuar lidhur me shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizime. Përfitime vlerësohet të ketë gjithashtu në aspektin mjedisor duke ulur impaktin në mjedis të shkarkimit të ujërave të ndotura urbane dhe rritjen e përgjegjshmërisë së përdoruesëve fundorë, qofshin këta konsumatorë privatë, tregtarë apo publikë, nëpërmjet implementimit të parimit ndotësi paguan. Përfitime vlerësohet të ketë më tej, në planin afatgjatë, edhe në buxhetin e Shtetit si rrjedhojë e kursimeve në shpenzime lidhur me subvencionet e shoqërive të UK që implementimi i opsionit të preferuar do të mundësojë.

Me gjithë ndikimin e përgjithshëm pozitiv që do të mundësohet nga implementimi i opsionit të preferuar, vërehen gjithashtu disa ndikime pozitive në planin afatshkurtër të cilat mund t'i prodhojë politika e adoptuar.

### **Ndikimet Ekonomike.**

Implementimi i opsionit të preferuar vlerësohet të sjellë kosto të drejtpërdrejta apo jo të drejtpërdrejta si në sektorin publik ashtu edhe privat, qofshin këta konsumatorë familjarë apo tregtare, përfshirë ata industriale.

Implementimi i politikës lidhur me rritjen e qëndrueshmërisë financiare të shoqërive UK për ofrimin në kushte optimale dhe me cilësi të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, të grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane, përcakton mbi buxhetin e këtyre të fundit një sërë detyrimesh financiare të cilat lidhen me:

- kryerjen e investimeve të nevojshme për zgjerimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm;
- zgjerimin dhe mirëmbajtjen e elementeve përbërës të sistemit të kanalizimit dhe ndërtimin dhe mirëmbajtja e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura;
- përgatitja e planeve të tyre 5 (pesë) vjeçare të investimeve dhe zhvillimit të rrjetit të furnizimit me ujë, përfshirë sistemin e grumbullimit dhe prodhimit të ujit të pijshëm;
- implementimin e planit të përgatitur nga MEI dhe AKUM, lidhur me afatet dhe burimet e financimit për ndërtimin, instalimin dhe operimin e sistemeve grumbulluese/kolektore dhe impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura për qendrat urbane sipas zonave të shërbimit, në përputhje me specifikimet e Direktivës 91/271/EEC, të 21 majit 1991, lidhur me trajtimin e ujërave të ndotura urbane;
- implementimi i kërkesave të përcaktuara projektligji dhe të zbatuara nga ERRU në lidhje me kushtet e shërbimit të furnizimit me ujë dhe për largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, lidhur me:
  - cilësinë e ujit dhe respektimin e normave të miratuara nga autoritetet përgjegjëse për shëndetin publik lidhur me përmbytjen e ujit të pijshëm;

- presionin e ujit në pikën e lëvrimin;
- qëndrueshmërinë e furnizimit me ujë të konsumatorëve;
- numrin e ndërprerjeve të furnizimit me ujë dhe kohëzgjatjen e tyre;
- matjen e konsumit të ujit;
- afatin për trajtimin e kërkesave për lidhje të reja ose rilidhjen e një konsumatori me rrjetin e furnizimit me ujë dhe/apo me sistemin e kanalizimeve të ujërave të ndotura;
- shpeshësinë e pastrimit të sistemit të kanalizimeve të ujërave të ndotura;
- afatin për trajtimin dhe riparimin e një defekti në sistemin tubacioneve të furnizimit me ujë apo të kanalizimeve të ujërave të ndotura;
- afatin për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të përdoruesve/klientëve.

Të tjera kosto operationale të shoqërive të UK lidhen me detyrimin e këtyre të fundit për marrjen e të gjitha masave të nevojshme për garantimin e cilësisë dhe higjienës së ujit të pijshëm që konsumohet nga konsumatorët brenda zonës së saj të shërbimit si dhe për mbrojtjen higjieno-sanitare të rezervuarëve, stacioneve të pompimit, depove të ujit dhe rrjetit shpërndarës deri tek përdoruesi, sipas kushteve minimale kombëtar të ujit të pijshëm. Në lidhje me këtë detyrim, projektligji parashikon kryerjen e analizave ditore në pika të caktuara në rrjetin shpërndarës dhe analiza periodike në burime, sipas një marrëveshje që shoqëria e ujësjellës-kanalizimeve lidh me Institutin e Shëndetit Publik.

Kosto për shoqëritë e UK parashikohet të lindin edhe në lidhje me verifikimin përpara vënies në përdorim dhe verifikimin periodik të matësit, instalimin e matësit dhe procedurat e bashkë-vulosjes të parashikuara nga projektligji të cilat duhet të kryhen pas instalimit nga shoqëria e ujësjellës-kanalizimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose nga personi juridik i autorizuar prej saj.

Implementimi i detyrimeve ligjore të mësipërme, të nevojshme në optikën e ofrimit në kushte optimale dhe me cilësi të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, të grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane, vlerësohet të ketë një impakt financiar fillestar mbi buxhetin e shoqërive të UK të cilat mund të kenë si pasojë reflektimin e tyre te konsumatori fundor në kushtet e zbatimit të parimit të rikuperimit të plotë koston me qëllim rritjen e performancës financiare të këtyre shoqërive. Kjo mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë tek konsumatori fundor duke detyruar shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve të kërkojnë rritjen e çmimit të shërbimit.

Megjithëkëtë, vlerësohet se impakti përfundimtar tek përdoruesit fundorë do të jete i limituar. Kjo për arsye të faktit se shumë prej shërbimeve të përcaktuara nga projektligji në lidhje me shoqëritë e UK janë shërbime të cilat ofrohen aktualisht prej tyre dhe përfshihen në tarifën e shërbimit aktuale. Gjithashtu, në projektligj përcaktohen modalitet e rritjes së çmimit duke kaluar vendimmarrjen nëpërmjet ERRU-së e cila kryen një analizë të plotë të kërkesës për rritjen e çmimit, i cili duhet të reflektojë kostot reale kapitale dhe operationale të ofruesve të shërbimit, në optikën e garantimit të një shërbimi me cilësi dhe të qëndrueshëm për klientët fundorë, duke siguruar një normë kthimi të arsyeshme të kapitalit të investuar në këto veprimtari në mënyrë që të nxitet

zhvillimi i sistemit të shpërndarjes së ujit të pijshëm dhe përmirësimin e sistemeve të trajtimit të ujërave të ndotura urbane, por pa harruar për asnjë çast aftësinë paguese të konsumatorëve.

Vlen për t'u theksuar gjithashtu se aktualisht, përballeshmëria e tarifave në Shqipëri ende nuk përbën problem për shkak të nivelit të tyre të ulët të cilat mbeten të përballeshme për një përqindje të lartë të popullsisë. Sipas statistikave, fatura e ujit aktualisht përfaqëson 2.2% të të ardhurave për një familje me nivel mesatar të ardhurash dhe rreth 3% të të ardhurave për familjet me të ardhura më të ulëta. Ky nivel mbetet nën pragun prej 5%, i cili monitorohet nga ERRU.

Gjithashtu, me qëllim shmangien e efekteve negative mbi kategori të caktuara konsumatorësh, në projektligj përcaktohet implementimi i një skeme të subvencionimit të shtresave në nevojë, përta i përket sasisë minimale të furnizimit me ujë, si dhe vendosjes së ujëmatësit dhe kostos administrative për lidhjen e kontratës së furnizimit me ujë. Implementimi i kësaj skeme subvencionimi pritet të minimizojë impaktin financiar të opsionit të preferuar mbi kategorinë e konsumatorëve më vulnerabel kundrejt luhatjeve të tarifave dhe njëkohësisht të garantojë respektimin e detyrimit të ofrimit të sasisë minimale të garantuar për furnizimit me ujë të pijshëm. Për këtë qëllim shoqëritë e UK kanë detyrimin të krijojnë dhe ruajnë një regjistër të konsumatorëve në nevojë.

Opsioni i preferuar, përcakton edhe një sërë kosto afatshkurtra në ngarkim të Buxhetit të Shtetit. Veçanërisht, këto kosto lidhen me:

- krijimin dhe menaxhimin e platformës kombëtare të aseteve të ujësjellës-kanalizime, e cila do të mundësojë një identifikim dhe rrjedhimisht shfrytëzim më të mirë dhe eficient të aseteve të UK;
- krijimin dhe menaxhimin e sistemit të integruar të informacionit të sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, i cili do të mundësojë në kohë reale vlerësimin e performancës të shoqërive të UK;
- trajnimin dhe çertifikimin e punonjësve të UK;
- aktivitetet e monitorimit të kryera nga AKUM në lidhje me sa më sipër.

Vlerësojmë se impakti i këtyre kostove do të jetë minimal në buxhetin e Shtetit për faktin se shumica e aktiviteteve të monitorimit dhe hartimit të planeve dhe masterplaneve të sektorit UK kryhen aktualisht nga AKUM. Gjithashtu, krijimi i këtyre kostove në plan afatshkurtër, do të justifikohet me benefitet që do të arrihen në planin afatmesëm dhe afatgjatë si rrjedhojë e rritjes së efikasitetit të ofrimit të shërbimeve të UK dhe rrjedhimisht kursimeve që do të vijnë në buxhetin e Shtetit nga gjenerimi i të ardhurave të një sektori UK eficient i cili mbulon kostot të veta operacionale.

Implementimi i opsionit të preferuar, parashikon gjithashtu konkretizimin e disa opsioneve agregimi mes shoqërive të UK, të parashikuara në Ligjin 139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore, por të cilat aktualisht nuk kanë gjetur aplikim konkret në praktikë.

Veçanërisht, opsionet e agregimit parashikuar nga projektligji mund të marrin formën e një "Bashkëpunimi ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore" për kryerjen e funksioneve dhe ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në dobinë e përbashkët, nëpërmjet

lidhjes dhe zbatimit të marrëveshjeve ose kontratave të përbashkëta, delegimit të kompetencave dhe përgjegjësisive të veçanta njëra-tjetrës. Ose krijimin e një “Subjekti të Kompetencave të Përbashkëta”, me anë të të cilit, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, si dhe me institucione të qeverisjes qendrore, lidhin marrëveshje të përbashkët për sigurimin e ofrimit të shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura brenda zonave respektive të shërbimit. Subjekti i Kompetencave të Përbashkëta mund të organizohet si një bord ose shoqëri tregtare, i krijuar nga dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore dhe/ose Ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën.

Në te dyja këto raste, implementimi i opsioneve të agregimit mund të parashikojë krijimin e disa kostove në planin afatshkurtër lidhur me:

- mbështetjen financiare të agregimit si rrjedhojë e miratimit nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës së marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet njësisive të vetëqeverisjes vendore për kryerjen e funksioneve dhe ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në dobinë e përbashkët; dhe
- me hyrjen si aksionar të Ministrisë së Infrastrukturës në Subjektin e Kompetencave të Përbashkëta dhe sigurimin e kapitalit të nevojshëm për financimin e investimeve kapitale të shoqërisë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” në rastin kur Subjektin e Kompetencave të Përbashkëta organizohet si shoqëri tregtare.

Edhe në këto raste vlerësojmë se impakti fillestar financiar lidhur me implementimin e opsioneve të agregimit, do të amortizohet plotësisht dhe do të rikuperohet me përfitimet financiare që pritet të sjellë agregimi ndërmjet shoqërive të UK dhe ekonomive të shkallës që realizohen në këtë mënyrë, duke rritur efikasitetin e shërbimit dhe uljen proporcionale të subvencioneve nga buxheti i Shtetit deri në rimëkëmbjen dhe pavarësinë totale të shoqërive të UK.

Nga ana tjetër, përben një risi të implementimit të opsionit të preferuar, mundësia e përfshirjes së një “Operatori të Alternativës së Fundit” (OAF), në rastet kur shoqëritë e UK humbasin licencën e operimit apo nuk kanë burimet financiare për të vazhduar aktivitetin normalisht, i cili merr përsipër kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe të largimit e trajtimit të ujërave të ndotura në zonën e caktuar. OAF mund të jetë me kapital privat ose shtetëror në formën e një shoqërie aksionare publike pronë e Ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën.

Në rastet e krijimit të një OAF me kapital publik, parashikohet një impakt financiar fillestar mbi buxhetin e Shtetit si rrjedhojë e aseteve të nevojshme për formimin e kapitalit fillestar të OAF. Megjithatë, në këtë rast, impakti financiar është i justifikuar nga nevoja për të ofruar shërbimin publik të UK dhe është një impakt financiar i përkohshëm, për periudhën e nevojshme që do të mundësonte arritjen e standardeve të shërbimit të përcaktuara nga ERRU për shoqërinë e UK që i ishte hequr licenca. Gjithashtu, impakti financiar afatshkurtër në buxhet lidhur me krijimin e OAF mund të limitohet nga përfitimet që sjell menaxhimi më efikas i aseteve të UK i kryer nga OAF.

Pavarësisht sa më sipër, implementimi i OAF kërkon monitorim të kujdesshëm, të cilin projektligji ja cakton aktivitetit të ERRU, në mënyrë që të ruhet balanca e interesit të konsumatorit për të marrë shërbimin në raport me dëshirën e OAF-së për të nxjerrë nga situata e vështirë financiare shoqërinë UK respektive, me qëllim që masat dhe reformat që do të ndërmerren të mos jenë proporcionalisht më të larta duke u reflektuar më pas në çmimin e konsumatorit fundor. Po kështu, projektligji lejon mundësinë e përdorimit të OAF-së vetëm përkohësisht dhe në këtë mënyrë kjo përbën një shmangie nga funksioni që ka njësia e vetëqeverisjes vendore për ofrimin e shërbimit të UK në territorin e saj, dhe mundësia e një ndikimi që mund të kishte potencialisht në raport me Ligjin 139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore i cili këtë tagër ja njeh Bashkive. Vlen të theksohet gjithashtu se implementimi i OAF është në përputhje me parimet dhe rendin Kushtetues të RSH si rrjedhojë e zbatimit të parimit të subsidiaritetit sipas të cilit parashikohet ndërhyrja e autoritetit më të lartë në rastin kur objektivat në lidhje me ushtrimin e funksioneve thelbësore për qytetaret nuk mund të realizohen në mënyrë të kënaqshme nga autoriteti lokal.

Siç u parashtua më sipër, projektligji parashikon detyrimin për të shtuar investimet në drejtim të mirëmbajtjes dhe ndërtimit të linjave të reja apo infrastrukturës së nevojshme për përmirësimin e cilësisë së shërbimit. Ndërtimi dhe operimi i impianteve të përpunimit të ujërave të ndotura në zbatim të parimit të shmangies së ndotjes mjedisore mund të ketë kosto të shtuar për shkak të investimit fillestar në ndërtimin e impianteve dhe kostove për mirëmbajtjen e tyre. Qeveria Shqiptare nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës asiston shoqëritë e ujësjellës kanalizimeve me qëllim gjetjen e financimeve të përshtatshme për realizimin e këtyre objektivave të përmirësimit të infrastrukturës. Të gjitha këto investime, në plan afatmesëm dhe afatgjatë duhet të amortizohen me qëllim rikuperimin e plotë të kostove dhe rrjedhimisht ekziston mundësia e shtuar që të ndikojnë drejtpërdrejtë në rritjen e çmimit të shërbimit ndaj qytetarëve. Kjo mund të realizohet duke orientuar investimet drejtë përmirësimit të infrastrukturës me qëllim minimizimin e humbjeve në rrjet, lidhjen e kontratave me të gjithë konsumatorët dhe pajisjen e tyre me matësa, marrjen e masave proaktive për eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjet.

Në lidhje me sa më sipër, në projektligjin e ri parashikohet shprehimisht mundësia e dhënies me konçesion apo me marrëveshje të partneritet publik-privat e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, i cili do të bëhet në përputhje me ligjin për konçesionet dhe partneritetin publik-privat dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi. Dhënia me konçesion apo me marrëveshje të partneritet publik-privat kryhet në bazë të një studim fizibiliteti të plotë i cili duhet të justifikojë dhënien e këtyre aseteve nëpërmjet formave të bashkëpunimit me privatin por duke mbajtur parasysh gjithmonë karakterin monopol të këtij shërbimi kur duhet të justifikohet dhe monitorohet me kujdes rritjet e çmimit të shërbimeve, detyrë kjo që ligjërisht i përket ERRU-së dhe me aprovimin paraprak të Ministrisë së Infrastrukturës në mënyrë që të garantohet vlerësimi i interesit publik në marrëveshjen përkatëse. Implementimi i mundësisë së dhënies me konçesion apo me marrëveshje të partneritet publik-privat e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në përputhje me sa më sipër, nuk parashikohet të krijojë impakt financiar negativ mbi financave publike, por përkundrazi shihet si një mënyrë efektive për arritjen e objektivave të rritjes së investimeve dhe qëndrueshmërisë financiare në sektor.

Nuk parashikohen ndikime financiare negative lidhur me implementimin e kërkesave rregullatore që projektligji parashikon për ERRU dhe licencimit dhe monitorimit nga kjo e fundit të subjekteve të UK. Funksionet e mësipërme zhvillohen aktualisht nga ERRU dhe mbulojnë nëpërmjet buxhetit të vetë entit rregullator.

### **Ndikimet Mjedisore.**

Implementimi i opsionit të preferuar në lidhje me parashikimin për sektorin e UK të zbatimit të parimit ndotësi paguan, konsiderohet si një gjetje e mirë për adresimin e problemit të mbrojtjes së mjedisit e cila do të sjellë përfitime të shumta në ruajtjen e pasurisë mjedisore dhe shfrytëzimin e përgjegjshëm të burimeve ujore. Veçanërisht, parashikimet në lidhje me ndalimin e shkarkimeve të ujërave të ndotura pa miratimin e UK apo ndalimin e ndërtimit të gropave septike dhe gropave banjo individuale për mbledhjen e ujërave të ndotura dhe llumrave, në zonat në të cilat ekziston rrjeti i tubacioneve të UK, ose detyrimin e personave, në zonat që nuk ekziston ende një rrjet tubacionesh të UK, që të kërkojnë largimin e ujërave të ndotura dhe llumrave sa herë që është e nevojshme nga ana e UK dhe detyrimin e kësaj të fundit për të përmbushur kërkesat e subjekteve, përbëjnë raste impakti pozitiv të drejtpërdrejtë në ruajtjen e ambientit mjedisor që sjell përfitime të menjëhershme në sferën e publikut të gjerë.

Gjithashtu, impakti pozitiv me efekte në mjedis parashikohet edhe nga implementimi i detyrimit mbi njësitë e vetëqeverisjes vendore, në zonat urbane, të projektojnë dhe zbatojnë sistemet e reja të kanalizimeve të ujërave të ndotura urbane të ndara nga sistemi i grumbullimit dhe shkarkimit të ujërave të shiut, për të eliminuar ndikimet negative tek impiantet ekzistuese të trajtimit të ujërave të ndotura apo ato që do të ndërtohen në të ardhmen.

Nga ana tjetër, është e rëndësishme të theksohet se, është i nevojshëm gjithashtu edhe përcaktimi me kujdes mekanizmave dhe monitorimit të aplikimit të parimit ndotësi paguan me qëllim që mungesa e efektivitetit dhe performancës në punë të shoqërive të ujësjellës kanalizimeve të mos reflektohet në kosto shtesë për shoqëritë dhe rrjedhimisht të transferohet te konsumatori fundor në formën e rritjes së tarifave.

### **Ndikimet sociale.**

Implementimi i opsionit të preferuar, i cili do të mundësojë sigurimin e qëndrueshëm të ofrimit në kushte optimale dhe me cilësi të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, të grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane, ka një impakt social të drejtpërdrejtë në të gjitha sferat e konsumatorëve të shërbimeve të UK i cili do të mundësojë më tej edhe një zhvillim ekonomik të vendit me efekte edhe kosto indirekte sociale në mirëqenien e përgjithshme të popullatës.

### **Arsyetimi i opsionit të preferuar**

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Hartimi i një ligji të ri për sektorin e ujit të pijshëm dhe kanalizimeve, u pa si një ndërhyrje e nevojshme për racionalizimin e gjithë sektorit dhe si mundësia më e përshtatshme për arritjen e objektivave të përcaktuara. Nevoja e draftimit të një ligji të ri për sektorin rezultoi si domosdoshmëri përgjatë analizimeve të problematikës

së sektorit dhe pas takimeve dhe konsultimeve me grupet e interesit, të cilat vunë në pah mangësitë dhe mungesën e racionalitetit të legjislacionit ekzistues, i cili shpesh rezulton të jetë i papërshtatshëm, për shkak të ndërhyrjeve të herëpashershme dhe të pa fragmentarizuara. Legjislacioni ekzistues kishte arritur një shkallë kontradiktoriteti ndërmjet dispozitave të tij, i cili pengonte zhvillimin optimal të sektorit strategjik të ujit të pijshëm dhe largimin, grumbullimin e trajtimin e ujërave të ndotura urbane.

Veçanërisht, përgjatë takimeve me grupet e interesit dhe me operatorët dhe investitorët potenciale, doli në pah nevoja për: përcaktimin e qartë të kompetencave ndërmjet aktoreve dhe institucioneve të përfshira në menaxhimin dhe operimin e sektorit të ujit dhe kanalizimeve, duke shmangur mbivendosjen e kompetencave që ishin krijuar ndërkohë si rrjedhojë e ndërhyrjeve të herëpashershme dhe të pa koordinuara; institucionalizimin dhe formalizimin e rolit të AKUM dhe të kontratave të performancës me titullarët e shoqërive UK, si një instrument dhe praktikë e cila kishte sjellë rezultate pozitive në sektor; riorganizimi dhe organizimi i shoqërive UK mbi baza agregimi për të rritur përfitimet ekonomike si rrjedhojë e ekonomive të shkallës që krijohen në këtë mënyrë dhe rritjen e investimeve në sektor; përforsimi i dispozitave në lidhje me ndëshkimin më rigoroz të dëmtimeve dhe lidhjeve të pa-autorizuara në sistemin e ujësjellës kanalizimeve; rritja e qëndrueshmërisë financiare dhe cilësore të shërbimeve të UK; përforsimi i autonomisë së ERRU si ent rregullator i pavarur i sektorit; si dhe krijimin e mekanizmave të posaçme për mundësitë e investimit në sektorin e ujit të pijshëm dhe kanalizimeve në të gjitha format e parashikuara nga legjislacioni ekzistues, duke konsideruar faktin që investimi i kërkuar në sektor, për të arritur një nivel optimal, konsiderohet të jetë në vlerën 1 miliard euro për periudhën 2019 - 2030.

Në këtë aspekt, projektligji i ri adreson të gjitha këto problematika dhe jep zgjidhje racionale për implementimin e kërkesave të operatoreve dhe grupeve të interesit të sektorit me qëllim operimin optimal dhe me cilësi të sektorit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve. Hartimi i një ligji të ri është analizuar si një mundësi e përshtatshme dhe një mjet efektiv për të adresuar mekanizmat ligjore dhe institucionalë me qëllim përmirësimin e treguesve financiarë të shoqërive të UK, llogaridhënien e mëtejshme të këtyre shoqërive në kushtet kur një pjesë e tyre marrin ende subvencione nga Qeveria, duke përmirësuar drejtpërdrejtë shërbimin ndaj konsumatorëve dhe duke rritur orarin e furnizimit me ujë. Gjithashtu, ky opsion përcakton qartësisht kompetencat e institucioneve të përfshira në këtë sektor, qoftë në nivel politikëbërje apo edhe në nivel zbatimi, duke shmangur konfuzionin dhe paqartësitë e krijuara në të shkuarën lidhur me mbivendosjen e kompetencave të organeve shtetërore.

### **Çështje të zbatimit**

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Për zbatimin konkret të opsionit të preferuar dhe implementimit të politikave të përcaktuara, do të jete e nevojshme hartimi dhe aprovimi i një sërë akte nënligjore, të cilat do të detajojnë dhe konkretizojnë politikat e përcaktuara në projektligj.

Në këtë aspekt, një rendësi të veçantë parashikohet të kenë ndërhyrjet me aktet nënligjore të Këshillit të Ministrave i cili do të jetë përgjegjëse për:

- miratimin e skemës së subvencionimit të shtresave në nevojë, sipas propozimit të Ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen sociale, të Ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën dhe Ministrisë përgjegjëse për financat;
- miratimin e kërkesave të cilësisë për ujin e pijshëm, sipas propozimit të Ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë;
- miratimin e tregueseve minimalë fiziko-kimikë të ujit të pijshëm, të cilët garantojnë shëndetin e konsumatorëve;
- miratimin e marrëveshjes standarte për krijimin dhe menaxhimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta, në rastet kur Ministria e infrastrukturës është pjesë e tij;
- caktimin dhe miratimin e vlerës së kapitalit themeltar dhe statuti i shoqërisë aksionare publike në rastet kur krijohet Operatori i Alternatives se Fundit me kapital publik, sipas propozimit të Ministrisë së Infrastrukturës;
- përcakton detyrimin për ndërtimin e sistemeve grumbulluese/kolektore dhe impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura për qendrat urbane me një numër të caktuar banorësh;
- miratimin e kushteve dhe normave teknike për projektimin dhe ndërtimin e impianteve të grumbullimit dhe prodhimit të ujit dhe rrjetit të furnizimit me ujë, sipas propozimit të Ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën;
- përcaktimin dhe shtrirjen e zonave të mbrojtura dhe të sigurisë, si dhe ndalimet dhe kufizimet e aplikueshme për këto zona, sipas propozimit të Ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën;
- miratimin e rregullave specifike që ndiqen nga shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve në rastet e situatave të emergjencës;
- miratimin e rregullores së veçantë për kushtet që duhet të plotësohen për shkarkimet në sistemin publik të ujërave të ndotura urbane, sipas propozimit të Ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën dhe Ministrisë përgjegjëse për mjedisin;
- transpozimin e plotë në legjislacionin shqiptar të Direktivës 91/271/EEC, mbi trajtimin e ujërave të ndotura urbane;

Gjithashtu, një aktor i rëndësishëm në implementimin konkret të opsionit të preferuar do të jetë Ministria përgjegjëse për infrastrukturën e cila, në mënyrë autonome dhe nëpërmjet AKUM, do të jetë përgjegjëse për:

- propozimin e të gjitha vendimeve, masave planeve, të cilat në mënyrë autonome apo në bashkëpunim me Ministri të tjera të linjës, do të dërgohen për aprovim në Këshillin e Ministrave, sipas projektligjit;
- përcaktimin e mekanizmave të nevojshëm ligjorë dhe institucionalë të qëndrueshëm për zbatimin e programit për trajnimin dhe çertifikimin, bazuar në testim të punonjësve në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura;
- përcaktimin e mënyrës së funksionimit, administrimit dhe monitorimit të sistemit të integruar të informacionit të sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe të sistemit sistemin kombëtar të menaxhimit të aseteve;
- miratimin e Kontratës tip të Performancës që do të nënshkruhet ndërmjet AKUM dhe titullarëve të shoqërive UK;

- miratimin e studimit të fizibilitetit të kryer nga organet e vetëqeverisjes vendore në lidhje me dhënien me konçesion ose nëpërmjet një marrëveshje të partneritetit publik-privat të shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura;

Rol të veçante paraqesin në implementimin e opsionit të preferuar edhe ministritë e tjera të linjës, si Ministria e Mjedisit, Shëndetësisë dhe Ekonomisë të cilat ndërhyjnë dhe marrin masat e nevojshme për hartimin e dokumenteve të parashikuara sipas këtij projektligji, në përputhje me kompetencat e tyre.

Se fundmi, rol kyç luan gjithashtu edhe enti rregullator i sistemit të furnizimit me ujë dhe trajtimit të ujërave të ndotura, ERRU, i cili sipas këtij projektligji kryen edhe harton të gjitha dokumentet që lidhen me funksionin e tij rregullator, dhe veçanërisht miratimin e tarifave të sektorit dhe licencimin e operatoreve që operojnë në të.

### Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmblodhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Një nga elementët më të rëndësishëm për zbatimin e opsionit të preferuar konsiderohet sistemi i monitorimit dhe vlerësimit, bazuar në një grup treguesish të përbashkët të performancës së shoqërive të UK. Rendësi të veçantë në këtë aspekt marrin Kontratat e performancës të nënshkruara ndërmjet AKUM dhe titullarëve të shoqërive të UK, të cilat parashikojnë arritjen e standarteve specifike të këtyre të fundit në lidhje me realizimin e objektivave përse i përket ofrimit në kushte optimale dhe me cilësi të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, të grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane, nëpërmjet garantimit të mbulimit të kostove operacionale të shoqërive UK, uljes së nivelit mesatar të ujit pa të ardhura dhe investimet e nevojshme në infrastrukturën tashmë të amortizuar lidhur me shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizime.

Analiza dhe vlerësimi i arritjes së standarteve të kërkuara, do të kryhet më tej edhe nga ERRU nëpërmjet miratimit të planeve të zhvillimit të të licencuarve të cilat duhet të jenë në përputhje me përmbushjen nga të licencuarit të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe me kushtet e licencës së tyre; Gjithashtu, ERRU, nëpërmjet mekanizmave të vetë rregullatorë, do të monitorojë dhe synojë nxitjen e efikasitetit dhe sigurisë së furnizimit me ujë nga ana e të licencuarve si dhe përdorimin sa më me efikasitet të ujit të pijshëm dhe përmirësimin e standarteve teknike dhe mjedisore lidhur me grumbullimin dhe trajtimin e ujit duke siguruar trajtimin dhe shkarkimin efektiv dhe higjenikisht të përshtatshëm të tyre për të gjitha zonat urbane duke filluar nga ato me popullsi më të madhe.

### Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

*Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - ët dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e ës dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.*

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
<b>Faktori zbritës</b>										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										

Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
<b>Kosto në total</b>										
<b>Kosto e zbritur në total =</b> Ë në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
<b>Përfitimi në total</b>										
<b>Përfitimi i zbritur në total =</b> Përfitimi në total x faktorin zbritës										
<b>Vlera aktuale e ë në total</b>										
<b>Vlera aktuale e përfitimit në total</b>										
<b>Vlera aktuale neto (VAN) =</b> Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e ë në total										

### Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			